

Armët e Vogla dhe Armët e Lehta në Evropën Juglindore

Manual për Parlamentarët 2010

Zyra Qendrore për Evropën Lindore dhe Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe Armëve të Lehta (SEESAC) ka mandatin e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal që t'u japë mbështetje të gjithë aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë duke ngritur aftësinë kombëtare dhe rajonale për të mbajtur nën kontroll dhe për të zvogëluar përhapjen dhe shpërdorimin e armëve të vogla dhe armëve të lehta dhe për të kontribuar kështu në rritjen e stabilitetit, sigurisë dhe zhvillimit në Evropën Juglindore dhe Lindore.

Për më shumë informacion kontaktoni me:

Team Leader, SEESAC
Hadzi Melentijeva 30
11000 Belgrade
Serbia

Tel: (+381) (11) 344 6353
Fax: (+381) (11) 344 6356
www.seesac.org

***AVAL në Evropën Juglindore,
Manual për Parlamentarët 2010***

Ky botim u përpilua nga SEESAC me mbështetjen e Forumit Parlamentar për Armët e Vogla dhe Armët e Lehta (Suedi). Falënderohen organizatat e mëposhtme që mundësuan përdorimin e disa prej materialeve të tyre: DCAF (Zvicër), Unioni Ndërparlamentar (Zvicër) dhe Saferworld (Britani e Madhe).


© SEESAC 2010 – Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

ISBN: 978-86-7728-130-4

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë pikëpamjet e autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Këshillit Rajonal për Bashkëpunim, apo të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim. Përcaktimet e përdorura dhe paraqitja e materialit në këtë botim nuk nënkuptojnë shfaqjen e mendimit të Këshillit Rajonal për Bashkëpunim, apo të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në lidhje me 1) statusin ligjor të cilit do shtet, territor ose zonë, apo të autoriteteve të tij ose grupeve të armatosura; apo 2) në lidhje me përvijëzimin e kufijve të tij.


Përmbajtja

Shkurtime	5
Manual për Parlamentarët për Armët e Vogla dhe Armët e Lehta	7
1 Çfarë janë armët e vogla dhe armët e lehta?	7
2 Çfarë ndikimi kanë në bashkësi dhe në shoqëri armët e vogla dhe armët e lehta?	7
3 Çfarë është kontrolli i armëve të vogla dhe armëve të lehta?	8
4 Origjina e problemeve që lidhen me armët e vogla dhe armët e lehta në Ballkanin Perëndimor	9
5 Roli i parlamenteve për kontrollin e armëve të vogla dhe armëve të lehta	10
6 Roli i parlamentarëve për kontrollin e armëve të vogla dhe armëve të lehta	11
Shtojca A – “Përcaktimi” i Kombeve të Bashkuara për armët e vogla dhe armët e lehta ..	13
Shtojca B – Kornizat dhe aktet ndërkombëtare	14
Shtojca C – Përmbledhje sipas vendeve	18
Shtojca D – Çfarë mund të bëni ju si parlamentar	30
Shtojca E – Botime të dobishme për armët e vogla dhe të lehta	34
Shtojca F – Pyetje të Komisionit Evropian për armët e vogla dhe armët e lehta	36



Shkurtime

CoC	Kodi i Etikës
DCAF	Qendra për Demokratizimin dhe Kontrollin e Forcave të Armatosura
EAPC	Këshilli për Partneritetin Euro-Atlantik (NATO)
EC	Komisioni Evropian
EU	Bashkimi Evropian
FSC	Forumi për Bashkëpunimin për Sigurinë (OSBE)
GGE	Grupi i Ekspertëve Zyrtarë (UN)
HMG	Mitraloz i rëndë
IDP	Person(a) të zhvendosur brendapërbrenda
LMG	Mitraloz i lehtë
MANPAD	Sistem i lëvizshëm i mbrojtjes ajrore
Mol	Ministria e Brendshme
MoS	Ministria për Sigurinë
NGO	Organizatë joqeveritare
OECD DAC	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, Komisioni i Asistencës për Zhvillim
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PoA	Program i Veprimit i Kombeve të Bashkuara për Armët e Vogla
PSC	Kompani(të) Private të Sigurisë
SAA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
SALW	Armët e vogla dhe armët e lehta
SCSP	Koordinatori i Veçantë i Paktit të Stabilitetit
SEE	Evropa Juglindore
SEESAC	Zyra Qendrore për Evropën Lindore dhe Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe Armëve të Lehta
SMG	Automatik
SSR	Reforma në sektorin e sigurisë
UN	Kombet e Bashkuara
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim



Manual për Parlamentarët për Armët e Vogla dhe Armët e Lehta

1. Çfarë janë armët e vogla dhe armët e lehta?

Nuk ka ndonjë përcaktim për armët e vogla dhe armët e lehta (SALW), i cili të jetë i pranuar në shkallë ndërkombëtare. Kombet e Bashkuara kanë formuluar çka ato i referohen si “përcaktim”,¹ por në të vërtetë kjo është një listë jo e plotë e llojeve të armëve dhe për këtë arsye është e vështirë që të përdoret në një mjedis diplomatik dhe operativ. Sidoqoftë, është rënë përgjithësisht dakord se termi armë të vogla dhe armë të lehta u referohet armëve dhe municioneve të kalibrit 100mm e poshtë. Për këtë arsye kjo listë përfshin jo vetëm pushkët, pistoletat dhe mitralozat mësymës, por edhe mortajat, raketat e lëvizshme tokë-ajër (MANPADS), raketat supembajtëse kundërtank, eksplozivët dhe lëndët plasëse konvencionale. Në Evropën Juglindore përdoret përcaktimi i mëposhtëm: **“të gjitha municionet konvencionale vdekjeprurëse që mund të mbahen nga një luftëtar i vetëm ose një automjet i lehtë, që gjithashtu nuk kërkon ndonjë aftësi të madhe për logjistikë dhe mirëmbajtje”.**

2. Çfarë ndikimi kanë në bashkësi dhe në shoqëri armët e vogla dhe armët e lehta?

Në botë ndoshta qarkullojnë të paktën pesëqind milion pushkë, pistoleta dhe SALW dhe këto armë gjithnjë e më shumë po luajnë një rol të rëndësishëm gjatë konflikteve dhe dhunës. Përgjithësisht SALW kanë një ndikim shumë

¹ Shtojca A.

Ndikimi i SALW

- Minojnë sundimin e ligjit.
- Mundësojnë krimin dhe jo stabilitetin.
- Acarojnë tensionet brenda bashkësisë dhe rrisin prapë e dhunës.
- Veprojnë si pengesë për zhvillimin.
- Burimet që shpenzohen për sigurinë nuk janë të disponueshme për zhvillim.
- Zhvlehtësojnë besimin dhe masat për krijimin e sigurisë.
- Kontribuojnë për shkelje dhe shpërdorime të të drejtave të njeriut.
- Shkurajojnë investimet dhe turizmin.
- Inkurajojnë zgjidhjen e dhunshme dhe jo zgjidhjen paqësore të çështjeve.
- Kontribuojnë për një “kulturë armësh”.
- Rrisin rrezikun për terrorizëm.
- Minojnë tregtinë e ligjshme të armëve.
- Përbëjnë një rrezik fizik për bashkësitë për shkak të municioneve të paqëndrueshme.

të madh në shoqëri. Thuhet se ato përdoren për të vrarë afërsisht 300.000 njerëz në vit në konflikte të armatosura dhe 200.000 në vit në veprimtari kriminale.¹ Miliona të tjerë terrorizohen, plagosen, gjymtohen ose nxirren me forcë nga shtëpitë që të jetojnë si refugjatë ose si persona të zhvendosur brendapërbrenda (IDP).

Në Evropën Juglindore përhapja e pakontrolluar dhe mbajtja e SALW vazhdon të përbëjnë një rrezik të madh për zhvillimin social dhe ekonomik. Duke mundësua dhunën dhe sjelljen e rrezikshme, SALW kontribuojnë për përhapjen në vazhdimësi të elementëve kriminalë dhe kriminit të organizuar. Ato gjithashtu kanë një efekt njëlloj negativ të sigurisë dhe masat për krijimin e besimit gjatë periudhës tranzitore në shumë prej vendeve të rajonit në rrugën drejt anëtarësimit në institucionet euro-atlantike.

3. Çfarë është kontrolli i armëve të vogla dhe armëve të lehta?

Termi “kontrolli i SALW” u referohet **“atyre veprimtarive, të cilat, së bashku, synojnë që të zvogëlojnë ndikimin social, ekonomik dhe mjedisor të përhapjes së pakontrolluar dhe zotërimit të SALW”**.

Duke u nisur nga ky qëllim, në kuadrin e planifikimit të programit duhet të hartohen në vijim objektivat operative që do të pasqyrojnë situatën brenda bashkësisë që synohet. Ndër këto objektiva mund të përfshihen:

¹ Kjo shifër është përdorur gjerësisht nga shumë burime, por gjithsesi mbetet për t'u vërtetuar nga pikëpamja statistikore. Për këtë arsye ajo duhet të përdoret me kujdes dhe duke bërë paralajmërimin e duhur.

Veprimtaritë për kontrollin e SALW

- Çështje ligjore dhe rregullator
 - Inspektimi i SALW
 - Sensibilizimi për SALW
 - Grumbullimi i SALW
 - Shkatërrimi i SALW
 - Menaxhimi i rezervave të SALW
 - Kontrolllet në pikat kufitare
 - Menaxhimi i informacionit
- a. kontrolli i armëve të ligjshme nëpërmjet legjislationit të vendit dhe regjistrimit;
 - b. zvogëlimi i numrit të armëve që janë në duar të kriminelëve;
 - c. zvogëlimi i numrit të aksidenteve nga armët dhe municionet;
 - d. bërja në mënyrë publike e lidhjes mes disponueshmërisë së armëve dhe shkallës së dhunës në shoqëri (si nga autoritetet e vendit ashtu edhe nga popullsia civile në përgjithësi);
 - e. sensibilizimi i bashkësisë në lidhje me këtë problem dhe, pra, solidariteti i bashkësisë;
 - f. ndërprerja e transportit dhe e tregtisë së kundraligjshme të armëve në tregun e zi;
 - g. kthimi i armëve të vjedhura nga bashkësia;
 - h. zvogëlimi i daljes në pah të armëve në bashkësi dhe trajtimi i kulturës së dhunës;
 - i. hartimi i akteve kundër përdorimit të kundraligjshëm të armëve; dhe/ose
 - j. përdorimi i kontrollit të SALW si një kuadër për krijimin e kapaciteteve në të ardhmen dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

4. Origjina e problemeve që lidhen me armët e vogla dhe armët e lehta në Ballkanin Perëndimor

Kanë qenë një sërë faktorësh që kanë ndikuar në përhapjen dhe mbajtjen e SALW në mënyrë të kundraligjshme në vendet e Ballkanit Perëndimor. Ndonëse në secilin vend situata paraqitet paksa e ndryshme, nga faktorët e mëposhtëm mund të përcaktohen disa modele të përbashkëta.

- **Konfliktet e kohëve të fundit.** Trashëgimia e konflikteve të kohëve të fundit në Ballkanin Perëndimor ka sjellë si rezultat përhapjen e ndjeshme të armëve në bashkësitë civile. Në shumë raste përhapja është mbështetur dhe kryer nga institucione shtetërore dhe formacione paraushtarake. Pra, qeveritë duhet të mbajnë përgjegjësinë kryesore për vendosjen e masave të efektshme për kontrollin e SALW me qëllim që të korrigojen politikat e paraardhësve të tyre.
 - **Zbatimi i paefektshëm i legjislacionit vendas, që çon në perceptime publike të pasigurisë.** Shumica e Parlamenteve të Ballkanit Perëndimor kanë miratuar ose janë në procesin e miratimit të legjislacionit për kontrollin e armëve, që është harmonizuar me standardet e BE-së. Në shumë raste këto ligje nuk janë plotësuar me aktet e nevojshme nënligjore, gjë që minon efektshmërinë e tyre. Edhe kur aktet nënligjore ekzistojnë, dega e ekzekutivit nuk e ka gjithmonë vullnetin e mjaftueshëm politik për të angazhuar burimet e nevojshme financiare, teknike dhe njerëzore me qëllim zbatimin e masave për kontrollin e SALW. Si rezultat,
- zvogëlohet përputhshmëria e përgjithshme me legjislacionin për sundimin e ligjit, që lidhet me mbajtjen e armëve të kundraligjshme.
- **Sektori kalimtar për Sigurinë.** Një sektor i dobët ose pak i zhvilluar për sigurinë krijon kërkesë për SALW. Një arsye e dobësisë së sektorit të sigurisë në Ballkanin Perëndimor vjen nga politizimi i këtij sektori. Ky politizim ka çuar në mungesën e llogaridhënies, rritjen e korrupsionit, mungesën e bashkërendimit, aftësi të kufizuara profesionale dhe rivalitete mes agjencive. Kjo, nga ana tjetër, ka krijuar boshllëqe të pjesshme për sa i përket sigurisë, boshllëqe që shpejt i mbushën fraksionet e armatosura ose grupet kriminale të organizuara. Rezultati i pashmangshëm ka qenë një pasiguri më e madhe, që çoi në rritjen e kërkesës për armë dhe përdorimin e tyre nga ana e bashkësisë.
 - **Kontrollet e paefektshme në kufi.** Reformat e vonuara në fushën e sigurisë në Ballkanin Perëndimor kanë krijuar pasiguri në strukturat e sigurisë dhe mundësinë për të nxjerrë përfitime nga statuskuoja. Mungesa e administrimit të integruar të kufijve në të kaluarën e kohëve të fundit ka krijuar mundësinë që krimi i organizuar të shfrytëzojë dobësitë dhe, si rrjedhim, të krijojë kanalet e trafikimit të qenieve njerëzore, drogave dhe armëve. Kështu, paaftësia e shtetit në të kaluarën për të siguruar kufij të sigurt krijoji mundësi më të lehta për furnizimin e SALW dhe nuk pati ndonjë vështirësi për të dhënë ultimatumin në bazë të perceptimeve publike të pasigurisë dhe rritjes së kriminalitetit.

- **Kultura e armëve.** Më shumë se në vendet tjera të Evropës, Ballkani Perëndimor ka një histori të gjatë dhe të rrënjësor të armëmbajtjes dhe përdorimit të tyre. Për shembull, Serbia ka numrin më të madh të gjahtarëve për kokë banori në tërë Evropën, ndërsa të gjitha vendet tjera përdorin armët për të festuar ditëlindjet, martesat, dhe festat fetare.¹ Fakti që kaq numër i madh i amvisërive posedojnë armë është një gjë problematike në kuptimin e sigurisë rajonale, dhe në masë të madhe është rritë potenciali për konflikte të dhunshme.

5. Roli i parlamenteve për kontrollin e armëve të vogla dhe armëve të lehta

Zhvillimi demokratik dhe siguria e njerëzve kërkojnë që organet ekzekutive të veprojnë në mënyrë efikase dhe efektive. Kjo kërkon përfundim dhe llogaridhënie: dy funksionet bazë të parlamenteve. Parlamentet lidhin qytetarët me shtetin dhe mund t'u kërkojnë qeverive që të japin llogari për veprimet ose mosveprimet e tyre. Parlamenti është një vend i natyrshëm për ndërmjetësim, ku mund të artikulojen pikëpamje konkurruese dhe ku dialogu mund të sjellë konsensusin. Këto funksione bazë janë thelbësore për të zbutur dhe zgjidhur çështje që lidhen me sigurinë e njerëzve. Në këto përgjegjësi duhet të përfshihet edhe kontrolli i SALW dhe ndikimi i parlamenteve në ndihmë të qeverive që të formulojnë dhe, më pas, të mbikëqyrin politikat kombëtare për kontrollin e SALW mund të jetë i madh. Ndër fushat kryesore ku parlamentet mund të ushtrojnë autoritetin dhe ndikimin e tyre përfshihen:

¹ 'Pushka ka djallin brenda,' Kultura e Armëve në Evropën Lindore, SEESAC, maj 2006

- **Krijimi i kornizës kombëtare legislative për kontrollin e SALW.** Në këtë kornizë duhet të përfshihet rregullimi i prodhimit të SALW, ndërmjetësimi, transporti dhe magazinimi, si edhe blerje, mbajtja dhe përdorimi i SALW. Legjislacioni duhet të parashikojë sanksionet e duhura.
- **Pjesëmarrja në formulimin e një politike kombëtare për kontrollin e SALW.** Së bashku me qeveritë parlamentet duhet të hartojnë një Strategji Kombëtare për SALW, një Plan Kombëtar Veprimi për SALW dhe, më pas, të ndihmojnë në zbatimin e tyre duke mbështetur krijimin e një Komisioni Kombëtar për SALW. Për më tepër, parlamentet duhet të bëjnë kujdes që legjislacioni vendas të mbështetet me sigurimin e kapaciteteve të mjaftueshme financiare dhe institucionale për autoritetet kombëtare, përfshirë kualifikimin dhe pajisjet.
- **Mbikëqyrja e zbatimit të kontrollit të SALW.** Parlamentet duhet të caktojnë ose të krijojnë një komision parlamentar që bashkë me Qeverinë të angazhohet në një debat të rregullt për kontrollin e SALW në shkallë kombëtare. Më tej, parlamentet duhet të kërkojnë raportim të rregullt nga ana e qeverive për transportin e SALW për të mundësuar një debat informativ për përputhjen e politikës së qeverive me legjislacionin.
- **Aktet ndërkombëtare për kontrollin e SALW.** Parlamentet duhet ta bëjnë përparësi kombëtare që: 1) të ratifikojnë traktatet shumëpalëshe për kontrollin e SALW që kanë nënshkruar qeveritë e tyre; ose 2) të

bëhen palë në këto traktate, nëse është e duhur. Më pas, dispozitat e këtyre traktateve dhe marrëveshjeve duhet të përfshihen në kohën e duhur në legjislacionin përkatës vendas dhe pastaj të zbatohen siç duhet.

- **Bashkëpunimi ndërkombëtar.** Parlamentet duhet të shkëmbejnë informacion me njëri-tjetrin në lidhje me legjislacionin kombëtar për kontrollin e SALW me qëllim që të krijojnë një perceptim më të mirë të kontrolleve rajonale dhe të identifikojnë praktikatat më të mira ekzistuese. Ato duhet të kontribuojnë gjithashtu në forumet e krijuara ndërkombëtare parlamentare, të cilat marrin në shqyrtim çështje që lidhen me SALW.

6. Roli i parlamentarëve për kontrollin e armëve të vogla dhe armëve të lehta


Parlamentarët kanë në dispozicion shumë instrumente të efektshme që mund t'i përdorin për të trajtuar çështje që lidhen me SALW:

- Në **rolin** e tyre **përfaqësues** parlamentarët mund të ngrenë pranë ekzekutivit çështje që janë shqetësuese (dhuna e armatosur, çdo shpërdorim i armëve të zjarrit nga ana e forcave shtetërore të sigurisë etj.). Pastaj, në lidhje me këtë çështje, ata mund të rrisin sensibilizimin në media, si dhe në zonat e tyre zgjedhore dhe shoqërinë civile, duke përcaktuar problemet që kanë të bëjnë me armët e vogla në nivel të bashkësisë dhe theksimi i shkaqeve themelore. Ata mund të ndikojnë te Qeveria të ndërmarrë hapa për ta

kthyer kontrollin e SALW në çështje politike.

- Në qoftë se një vend ka një Komision Kombëtar për SALW, parlamentarët duhet të jenë të përfaqësuar formalisht në Komision (në shumë vende janë të përfaqësuar grupe të shoqërisë civile).
- Si anëtarë të delegacioneve zyrtare parlamentarët duhet të marrin pjesë në konferenca, seminare etj. për SALW (për shembull, në Forumin e OSBE-së për Bashkëpunimin për Sigurinë (FSC), në mbledhjet për SALW) me qëllim që të përfaqësojnë shqetësimet e qytetarëve në një mënyrë që diplomatët nuk mund ta bëjnë, duke i kërkuar ndërkohë qeverisë që të japë llogari për angazhimet e marra në këto mbledhje.
- Në **rolin** e tyre **legjislativ** parlamentarët mund të iniciojnë ligje të reja ose të propozojnë një analizë të plotë të legjislacionit ekzistues për mbajtjen e armëve nga civilët, transportin e armëve dhe kontrollet e eksportit të armëve, proceset e grumbullimit vullnetar të armëve.
- Në **rolin** e tyre **mbikëqyrës** parlamentarët mund të sigurojnë që ekzekutivi të respektojë dhe të zbatojë angazhimet e veta ndërkombëtare (p.sh. traktatet, konventat etj.).

Shtojca D propozon një gamë veprimtarish në të cilat mund të angazhohen parlamentarët për t'i ofruar mbështetje kontrollit të SALW, ndërsa Shtojca E përmban referenca për botimet specifike në rajon dhe vende të ndryshme, të cilat përmbajnë informacione më të hollësishme se sa ky Manual.



Shtojca A – “Përcaktimi” i Kombeve të Bashkuara për armët e vogla dhe armët e lehta

Në vitet e nëntëdhjeta një Grup i Kombeve të Bashkuara me Ekspertë Qeveritarë (GGE) hartoi një përkufizim të SALW dhe ky “përcaktim” i rendiste ato në tri kategori:

Armë të vogla

- Revolverët dhe pistoletat vetëmbushëse
- Pushkët dhe karabinat
- Automatikët (SMG)
- Pushkët mësymëse
- Mitralozat e lehtë (LMG)

Armët e lehta

- Mitralozat e rëndë (HMG)
- Granatahedhëset e dorës, nën grykë dhe të montuara
- Armët e lëvizshme kundërajrore
- Armët e lëvizshme kundërtank dhe pushkët pa zbrapsje
- Hedhësit e lëvizshëm të raketave kundërtank dhe sistemet e raketave
- Hedhësit e lëvizshëm të sistemeve të raketave kundërajrore
- Mortajat (e kalibrit <100mm)

Municione dhe lëndë plasëse

- Predhat (fishekët) për armë të vogla
- Predhat dhe raketat për armë të lehta
- Depozitat e lëvizshme me raketa ose predhat me një veprim dhe sistemet kundërajrore dhe kundërtank
- Granatat kundër trupave dhe kundërtank
- Minat tokësore
- Lëndët plasëse

Shtojca B – Kornizat dhe aktet ndërkombëtare

Vitet e fundit është krijuar një fond i konsiderueshëm aktesh ndërkombëtare për trajtimin e përhapjes së SALW. Në nivel ndërkombëtar dhe rajonal janë krijuar një numër marrëveshjesh dhe forumesh për dialog konkret. Përveç kësaj, donatorët dhe vendet përfituese kanë ndërmarrë një numër projektesh specifike. Vendet e Evropës Juglindore kanë rënë dakord që ta trajtojnë përhapjen e SALW në mbarë rajonin nën ombrellën e një sërë marrëveshjesh ndërkombëtare të iniciuara nën kujdesin e BE-së, EAPC të NATO-s, OSBE-së ose të Kombeve të Bashkuara.

KORNIZA OSE AKTE PËRMBLEDHJE

AKTE TË KOMBEVE TË BASHKUARA

Protokolli i Kombeve të Bashkuara për Armët e Zjarrit¹

Ky është dokumenti i parë i politikës së veprimit që kanë miratuar Kombet e Bashkuara në lidhje me politikën për SALW. Ky Protokoll plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara të vitit 2001 kundër Krimit të Organizuar Ndërkufitar. Ndër masat e përcaktuara në Protokollin e Kombeve të Bashkuara për Armët e Zjarrit përfshihen:

- Forcimi i legjislacionit kombëtar; dhe
- Rritja e shkëmbimit të informacionit mes qeverive për armët e kundraligjshme të zjarrit, tregtarët e tyre, burimet dhe rrugët e trafikimit.

Programi i Veprimit i Kombeve të Bashkuara për SALW²

Programi i Veprimit i Kombeve të Bashkuara trajton një fushë veprimi më të plotë që lidhet me armët e zjarrit sesa Protokolli i Kombeve të Bashkuara për Armët e Zjarrit dhe që lidhet gjithashtu transportin shtet me shtet të SALW. Ai parashikon sferat e veprimit kundër SALW në nivel ndërkombëtar, rajonal, kombëtar dhe vendor dhe kërkon bashkëpunim të ngushtë mes shteteve për të arritur objektivat e deklaruara, përfshirë shkëmbimin e informacionit, asistencën dhe vendosjen e standardeve, dhe nënvizon rolin e organizatave rajonale për nxitjen e këtij bashkëpunimi. Qeveritë kanë marrë angazhim që të mblidhen çdo dy vjet për të shkëmbyer informacion në lidhje me zbatimin nga ana e tyre të Programit të Veprimit.

¹ Protokolli kundër Prodhimit të Kundraligjshëm dhe Trafikimit të Armëve të Zjarrit, Pjesëve dhe Përbërësve të tyre dhe Municionit, plotësuar me Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkufitar (Protokolli për Armët e Zjarrit). (Ka hyrë në fuqi më 3 korrik 2005).

² Programi i Veprimit i Kombeve të Bashkuara për të Parandaluar, Luftuar dhe Çrrënjësuar Tregtinë e Kundraligjshme të Armëve të Vogla dhe Armëve të Lehta në të Gjitha Aspektet e Saj. (Dokument i Kombeve të Bashkuara A/CONF.192/15). Korrik 2001.

PROCESET E OSBE-së

Dokumenti i OSBE-së për Armët e Vogla dhe të Lehta³

Dokumenti i OSBE-së për SALW njih kontributin që kanë dhënë grumbullimet destabilizuese të SALW në konfliktet rajonale të kohëve të fundit. Ai bën një ndarje të detyrave për të luftuar përhapjen dhe për t'i grupuar SALW në disa kategori normash dhe masash, si dhe parashikon një rol të mundshëm në procesin e zbatimit të misioneve dhe zyrave të tij në terren. Këto kategori përfshijnë:

- Rregulloret kombëtare për SALW, përfshirë kontrollet për prodhimin, vënien e shenjave dhe mbajtjen e procesverbaleve;
- Monitorimin dhe rregullimin e tregtisë ndërkombëtare të SALW, përfshirë rregullimin e ndërmjetësimit, kriteret e zakonshme të eksportit, kontrollet e transportit dhe shkëmbimin e informacionit; dhe
- Grumbullimin e armëve, administrimin e rezervave dhe eliminimin e tepërive – me rëndësi themelore për zvogëlimin e grumbullimeve destabilizuese, përhapjen e pakontrolluar të armëve të vogla dhe parandalimin e trafikimit të kundraligjshëm.

Dokumenti i OSBE-së për Stoqet e Municioneve Konvencionale⁴

Dokumenti i OSBE-së për Stoqet e Municioneve Konvencionale u miratua në vitin 2003. Ai plotëson Dokumentin e OSBE-së për SALW. Marrëveshja përfshin të gjitha kategoritë e municioneve konvencionale, lëndët plasëse dhe pajisjet shpërthyesë, përfshirë municionet për armët e rënda, të gjitha llojet e minave, raketat dhe lëndën djegëse për raketat, granatat, shpërthyesit e mbushjes plasëse. Dokumenti përmban procedura praktike dhe mekanizma për asgjësimin e këtyre stoqeve të tepërta. Objektivi përfundimtar është që shtetet pjesëmarrëse të kenë mundësi të rrisin kapacitetet e tyre kombëtare në mënyrë që t'i zgjidhin vetë problemet specifike, duke u mbështetur, nëse është e nevojshme, në pasuritë e veta.

Vendimi i OSBE-së për Sistemet e Lëvizshme të Mbrojtjes Ajrore (MANPADS)⁵

Vendimi i OSBE-së për MANPADS miraton parimet e rritjes së kontrollit të eksporteve të MANPADS, parime këto që janë nxjerrë nga "Elementet e Kontrolleve të Eksporteve të Sistemeve të Lëvizshme të Mbrojtjes Ajrore" të Marrëveshjes së Vasenar-it.

Vendimi i OSBE-së për Ndalimin e Certifikatave të Përdoruesit⁶

Ky vendim afirmon sërish angazhimet e shteteve pjesëmarrëse për të vëzhguar, si një nga standardet kyç që nënvizon dokumentacionin për eksportet, që të mos lëshohet asnjë licencë për eksport pa certifikatën e vërtetuar të përdoruesit të fundit ose ndonjë formë tjetër autorizimi zyrtar të lëshuar nga shteti pritës. Vendimi përfshin kërkesat e dokumentacionit për Certifikatën e Përdoruesit të Fundit dhe mekanizmat.

³ Dokument i OSBE-së për Armët e Vogla dhe Armët e Lehta. (FSC.JOUR/314). 24 nëntor 2000

⁴ Dokument i OSBE-së për Stoqet e Municioneve Konvencionale. (FSC.DOC/1/03). 19 nëntor 2003.

⁵ Vendimi i OSBE-së për Sistemet e Lëvizshme të Mbrojtjes Ajrore. (Vendim Nr. 7/03). (FSC.DEC/07/03). 23 korrik 2003.

⁶ Vendimi i OSBE-së për Certifikatat e Përdoruesit të Fundit dhe Procedurat e Verifikimit të Eksporteve të Armëve të Vogla dhe Armëve të Lehta. (Vendim nr. 05/04). (FSC.DEC/5/04). 17 nëntor 2004.

KORNIZA OSE AKTE PËRMBLEDHJE

Vendimi i OSBE-së për Ndërmjetësimin⁷

Ky vendim parashtron parimet e pranuar nga shtetet për të kontrolluar ndërmjetësimin për armë me qëllim që të shmanget anashkalimi i sanksioneve të miratuara nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara; vendimet e marra nga OSBE, përfshirë kriteret e parashtruara në Pjesën III A të Dokumentit të OSBE-së për SALW; të tjera marrëveshje për SALW ose marrëveshje të tjera për kontrollin e armëve dhe çarmatimin, me qëllim që të minimizohet rreziku i shmangies së drejtimit të SALW për në tregje të kundraligjshme, mes të tjerash, në duart e terroristëve dhe grupeve të tjera kriminale; dhe që të forcohet kontrolli i eksportit të SALW. Për t'i arritur këto objektiva, shtetet pjesëmarrëse do të bëjnë përpjekje me qëllim që legjislacioni i tyre ekzistues ose i ardhshëm kombëtar në lidhje me ndërmjetësimin për armët të jetë në përputhje me dispozitat që përmban ky dokument.

AKTET DHE PROCESET E BE-së

Direktiva e BE-së për Kontrollin e Blerjes dhe Mbajtjen e Armëve⁸

Direktiva e BE-së u miratua më 1 janar 1993 si një masë shoqëruese e heqjes së kontrolleve në kufijtë e brendshëm brenda Bashkimit Evropian. Të gjitha vendet që dëshirojnë të pranohen në BE duhet ta harmonizojnë legjislacionin e tyre me këtë Direktivë. Direktiva përcaktonte rregullat për blerjen dhe mbajtjen e armëve të zjarrit dhe për transportin e armëve të zjarrit në një shtet tjetër anëtar. Direktiva parashikon një procedurë që mbështetet te çështja e licencës për transportin e përcaktuar të armëve të zjarrit te një shtet anëtar. Direktiva gjithashtu kërkon një autorizim për mbajtjen e armëve të zjarrit kur udhëtohet nga njëri shtet anëtar te tjetri. Direktiva përfshiu lejen evropiane për armë zjarri, dokument ky që i lëshohet me kërkesë të autoriteteve të një shteti anëtar një personi që mban dhe përdor armë zjarri në mënyrë të ligjshme. Kriteret e Direktivës janë zgjeruar me amendamentin e vitit 2008⁹.

Veprimi i Përbashkët i BE-së për SALW¹⁰

BE, nëpërmjet Veprimit të tij të Përbashkët për të luftuar grumbullimin destabilizues dhe përhapjen e armëve të vogla, u ofron asistencë financiare dhe teknike vendeve, grupeve të vendeve, organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-ve, që kërkojnë mbështetje. Që nga viti 1999, nëpërmjet Veprimit të Përbashkët BE ka miratuar 14 veprime të tilla në Evropën Lindore, në Amerikën Latine dhe Karaibe, në Azi dhe Afrikë. Ndër përparësitë gjeografike të përcaktuara nga Këshilli Evropian, vëmendje e posaçme i është kushtuar asgjësimit të stoqeve ekzistuese të SALW në Evropën Lindore dhe Juglindore dhe veprimeve në mbështetje të moratoriumeve rajonale për armët e vogla në Afrikë.

⁷ Vendimi i OSBE-së për Parimet e Kontrollit të Ndërmjetësimit për Armët e Vogla dhe Armët e Lehta. (Vendim nr. 08/04). (FSC.DEC/8/04). 24 nëntor 2004.

⁸ Direktiva e Këshillit 91/477/EEC e 18 qershorit 1991 për Kontrollin e Blerjes dhe Mbajtjen e Armëve, OJ L 256, 13.9.1991, f. 51–58.

⁹ Direktiva e Këshillit 2008/51/EC.

¹⁰ Veprimi i Përbashkët i Këshillit të BE-së për kontributin e Bashkimit Evropian për të luftuar grumbullimin destabilizues dhe përhapjen e armëve të vogla dhe armëve të lehta dhe për të shfuqizuar Veprimin e Përbashkët 1999/34/CFSP. (2002/589/CFSP). 12 korrik 2002.

KORNIZA OSE AKTE PËRMBLEDHJE

Qëndrimi i përbashkët i BE-së për Eksportet e Armëve¹¹ (ish Kodi i Etikës i BE-së për Eksportet e Armëve)

Kodi i Etikës i BE-së përfaqëson një model për kontrollin e eksporteve ushtarake konvencionale, që u paraqit nga Bashkimi Evropian si një angazhim politik në vitin 1998 dhe u shndërrua në Qëndrim të Përbashkët në dhjetor 2008. Ai përcakton kriteret të përbashkëta për miratimin e eksporteve dhe parashikon dispozita në lidhje me transparencën, siç është botimi i një Raporti Vjetor që i ofron shoqërisë civile dhe komunitetit zyrtar një mjet për të vlerësuar performancën e shteteve të veçanta.

Strategjia e BE-së për të Luftuar Grumbullimin e Kundraligjshëm dhe Trafikimin e SALW dhe Municionit¹²

Më 16 dhjetor 2005, Këshilli Evropian miratoi një Strategji për të mbështetur Veprimin e Përbashkët për SALW të vitit 2002 (2002/589/CFSP). Strategjia është hartuar brenda kornizës së Strategjisë Evropiane për Sigurinë (2003), si dhe të një strategjie të ngjashme për Armët e Shtatërrimit në Masë të vitit 2003. Synimi është që të krijohet një *“qëndrim i integruar dhe një plan i plotë veprimi për të luftuar tregtinë e kundraligjshme të SALW dhe municionet e tyre”*.

Qëndrimi i Përbashkët i BE-së për sa i përket Ndërmjetësimit për Armët¹³

Objektivi i Qëndrimit të Përbashkët është që të kontrollohet ndërmjetësimi për armët me qëllim që të shmanget anashkalimi i embargove për armët që kanë vendosur Kombet e Bashkuara, BE ose OSBE, si dhe i kriterëve të sanksionuara në Qëndrimin e Përbashkët të BE-së për Ndërmjetësim për Armët. Ai i detyron shtetet anëtare të BE-së që të krijojnë një kornizë të qartë ligjore për veprimtaritë ndërmjetësuese. Pjesë e kësaj kornize është një sistem licencimi, sipas të cilit, për transaksione specifike ndërmjetësimi kërkesat për marrjen e licencës vlerësohen në bazë të dispozitave që përmban ky dokument. Qëndrimi i Përbashkët gjithashtu parashikon krijimin e një mekanizmi për shkëmbimin e informacionit për veprimtaritë ndërmjetësuese.

PAKTI I STABILITETIT PËR PROCESIN NË EVROPËN JUGLINDORE

Plani i Zbatimit Rajonal i Paktit të Stabilitetit për Armët e Vogla dhe Armët e Lehta¹⁴

Në nëntor 2001 Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore (SCSP)¹⁵ doli me një Plan të Zbatimit Rajonal (SP SALW RIP) për të luftuar përhapjen e pakontrolluar të SALW. Ky plan u rishikua në maj 2006. Ndryshe nga shumë marrëveshje të tjera për kontrollin e armëve, SP SALW RIP ofronte mekanizma konkrete për të ndihmuar vendet që të zbatojnë angazhimet dhe për t'i përfshirë këto qeveri në caktimin e përparësive dhe vendimmarrjen për përpjekje pan-rajonale. Këto mekanizma mbështeten ose zbatohen përmes SEESAC në nivel rajonal dhe përmes një numri nismash me mbështetje ndërkombëtare në vende të veçanta.¹⁶ Në nivel politik, SP SALW RIP duhet të konsiderohet një sukses dhe ka ofruar një mandat të vlefshëm dhe të efektshëm për të dhënë përgjigje të efektshme në nivel veprues.

¹¹ Qëndrimi i përbashkët i Be-së 2008/944/CFSP

¹² Strategjia e BE-së për të Luftuar Grumbullimin e Kundraligjshëm dhe Trafikimin e SALW dhe Municionet e Tyre. Këshilli i Bashkimit Evropian 5319/06 i 13 janarit 2006. (Miratuar më 15-16 dhjetor 2005.)

¹³ Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit 2003/468/CFSP i 23 qershorit 2003 në lidhje me kontrollin e ndërmjetësimit për armë. OJ L 156, 25.05.2003, f. 79-80.

¹⁴ Lufta kundër Përhapjes së Armëve të Vogla dhe Armëve të Lehta – Plani i Zbatimit Rajonal i Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore, 28 nëntor 2001. (Rishikuar në maj 2006). (www.stabilitypact.org).

¹⁵ Ku aderohet Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Moldavia, Rumania dhe Serbia.

¹⁶ Projekte të PNUD-it për Kontrollin e SALW.

Shtojca C – Përmbledhje sipas vendeve

Shqipëria

Progresi i bërë në lidhje me SALW

Shqipëria ka bërë progres në asgjësimin e stoqeve të veta të mëdha të armatimit dhe municionit të vjetruar. Asgjësimi i 90 mijë tonëve të municionit përmes programit “Armët në këmbim për Zhvillimin” po realizohet që nga viti 2002, dhe duhet të përfundojë në vitin 2010.¹ Një pjesë nga kriteret për anëtarësim në NATO ishte pastrimi i stoqeve të mëdha me SALW më të vdekjeprurëse në vend, dhe me ndihmën e SHBA² i përfunduar në janar 2008. Prapëseprapë, vetëm dy muaj më vonë një shpërthim në depon e municionit sensibilizoi çështjen se ka ngelë shumë punë për të bërë në lidhje me magazinimin e SALW në Shqipëri.³

Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) me BE-në në muajin qershor 2006. Ky është një hap i suksesshëm drejt arritjes së objektivit për t’u bërë shtet anëtar i BE-së. Gjatë një pjese të këtij procesi do të duhet që Shqipëria t’i japë përgjigje pyetësorit të Komisionit Evropian për sa i përket përgatitjes së saj për t’u bërë vend kandidat. Ky pyetësor i Komisionit Evropian përmban pyetje që lidhen me SALW, të cilat do të ishin të rëndësishme për Shqipërinë (shih Shtojcën E).

Më 5 prill 2007, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin e ri për Kontrollin Shtetëror të ‘Eksportit dhe importit të armëve, pajisjeve ushtarake dhe mallrave me përdorim të dyfishtë’.

Në vitin 2009 Shqipëria botoi Raportin e saj të parë Vjetor për Eksport të Armëve për periudhën kohore prej 2007 deri 2008. Raporti përmban përshkrimin e legjislacionit kombëtar të lidhur me sistemin e kontrollit të eksportit të pajisjeve ushtarake dhe pajisjeve dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë, si edhe përshkrim fazave të procesit të licencimit.

¹ <http://www.un-casa.org/CountryProfile/CountryProfileCountryInfo.aspx?Col=2&pos=30>

² <http://www.globalsecurity.org/military/library/news/2008/01/mil-080103-usia02.htm>

³ http://www.undp.hr/upload/file/200/100185/FILENAME/Conventional_Ammunition_Stockpiles_Parliamentary_Handbook_2008.pdf

Aktet ndërkombëtare

Statusi i pjesëmarrjes së Shqipërisë dhe zbatimi i akteve përkatëse për kontrollin e SALW:

Akti ndërkombëtar	Data e aderimit ose e ratifikimit
Qëndrimi i Përbashkët i BE-së për Eksportet e Armëve	gusht 2003
Qëndrimi i Përbashkët i BE-së për sa i përket Ndërmjetësimit për Armët	Pjesërisht i miratuar
Direktiva e BE-së për Kontrollin e Blerjes dhe Mbajtjen e Armëve	Jo
Dokument i OSBE-së për SALW	Nëntor 2000
Dokument i OSBE-së për Stoqet e Municionit Konvencional	Dhjetor 2003
Vendimi i OSBE-së për MANPADS	Korrik 2003
Vendimi i OSBE-së për Ndalimin e Certifikatave të Përdoruesit	Nëntor 2004
Vendim i OSBE-së për Ndërmjetësimin	Nëntor 2004
Plani i Zbatimit Rajonal i Paktit të Stabilitetit për SALW	Nëntor 2001
Programi i Veprimit të Kombeve të Bashkuara për Armët e Vogla dhe Armët e Lehta	Korrik 2001
Protokolli i Kombeve të Bashkuara për Armët e Zjarrit	Shkurt 2008

Rekomandime për parlamentarët shqiptarë

- Të mbështesin aderimin e Direktivës së BE-së për Kontrollin e Blerjes dhe Mbajtjes së Armëve
- Të mbështesin miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kontrollin e SALW;
- Të mbështesin krijimin e një Komisioni të efektshëm Kombëtar për SALW;
- Të nxisin transparencën për armët e vogla dhe armët e lehta përmes mbikëqyrjes së rregullt parlamentare të mekanizmave për kontrollin e SALW

Bosnjë e Hercegovina

Progresi i bërë në lidhje me SALW

Bosnjë e Hercegovina ka bërë një përparim të rëndësishëm vitet e fundit në fushën e kontrollit të SALW. Bordi i Bashkëndimit për Kontrollin e SALW u krijua në vitin 2005 dhe në maj 2006 Këshilli i Ministrave miratoi Strategjinë Kombëtare për SALW. Fushata për Mbetjet e Mjeteve Shpërthyes nga Lufta (ERW) filloi në vitin 2008 dhe faza e saj e parë përfundoi rishtazi. Ajo do të vazhdon deri në mes të vitit 2011 duke qenë e financuar me më shumë se 2 milion Euro dhe parashihet që shumica e mjeteve shpërthyes të mbetura në BeH të pastrohen deri atëherë. Gjatë kësaj kohe gjithashtu do të ngrihen kapacitetet e institucioneve vendore për t'u marrë me stoqet e mbetura.¹

Direktiva e BE-së për Kontrollin e Blerjes dhe Mbajtjes të Armëve mund të ngelë e pazbatuar, por Republika Sërpska ndryshoi Ligjin e saj për Armët (Gazeta Zyrtare 01-1277/07) në mars 2009 dhe pjesërisht e harmonizoi atë me Direktivën. Federata e Bosnjë e Hercegovinës dhe Qarku i Bërçkos janë në proces të harmonizimit me Direktivën 91/477/EEC dhe me Direktivën 2008/51/EC. Qarku i Bërçkos shumë shpejt mund të sjell ligjin e vet për armë të harmonizuar me direktivat e BE-së.

Në shkurt 2009, BeH në mënyrë të njëanshme u rendit me Qëndrimin e Përbashkët të Këshillit të BE-së 2008/944/CFSP. Qëndrimi i Përbashkët përmban akt domethënës të përmirësuar dhe të freskuar i cili zëvendëson Kodin e Etikës për Eksportet e Armëve. BeH vazhdon të publikojë raporte vjetore për eksportet e armëve në përputhje me Qëndrimin e Përbashkët të BE-së. Legjislacioni vendor që duhej të miratohet përfshinte Ligjin për Kontroll të Blerjes së Armëve dhe Pajisjeve Ushtarake (qershor 2009)², dhe Ligjin e ndryshuar për Prodhimin e Armëve dhe Pajisjeve Ushtarake (mars 2009).³

¹ Raporti i Tetë Vjetor për zbatimin e Veprimit të Përbashkët të Këshillit me date 12 korrik 2002 për kontributin e Bashkimit Evropian në luftën kundër akumulimit destabilizues përhapjes së armëve të vogla dhe armëve të lehta (2002/589/CFSP), 20 janar 2010

² Gazeta Zyrtare e BeH Nr. 53/09

³ Ibid.

Aktet ndërkombëtare

Statusi i pjesëmarrjes së Bosnjë-Hercegovinës dhe zbatimi i akteve përkatëse për kontrollin e SALW:

Akti ndërkombëtar	Data e aderimit ose e ratifikimit
Qëndrimi i Përbashkët BE-së për Eksportet e Armëve	Shkurt 2009
Qëndrimi i Përbashkët i BE-së për sa i përket Ndërmjetësimit për Armët	Pjesërisht
Direktiva e BE-së për Kontrollin e Blerjes dhe Mbajtjen e Armëve	Jo
Dokument i OSBE-së për SALW	Nëntor 2001
Dokument i OSBE-së për Stoqet e Municionit Konvencional	Dhjetor 2003
Vendimi i OSBE-së për MANPADS	Korrik 2003
Vendimi i OSBE-së për Ndalimin e Certifikatave të Përdoruesit	Nëntor 2004
Vendim i OSBE-së për Ndërmjetësimin	Nëntor 2004
Plani i Zbatimit Rajonal i Paktit të Stabilitetit për SALW	Nëntor 2001
Programi i Veprimit të Kombeve të Bashkuara për SALW	Korrik 2001
Protokolli i Kombeve të Bashkuara për Armët e Zjarrit	Prill 2008

Rekomandime për parlamentarët e Bosnjë e Hercegovinës

- Të mbështesin aderimin e Direktivës së BE-së për Kontrollin e Blerjes dhe Mbajtjes së Armëve
- Të mbështesin krijimin e kapaciteteve të institucioneve të Bosnjë-Hercegovinës duke miratuar ligje që parashikojnë shpërndarjen e burimeve të mjaftueshme buxhetore;
- Të angazhohen në mbikëqyrjen e zbatimit të reformave në polici dhe mbrojtje përmes komisioneve përkatëse parlamentare, në mënyrë të veçantë kur reformat lidhen me politikat për armët dhe municionet;
- Të marrin nismën për vendime ose ligje që synojnë shkatërrimin e armëve dhe municioneve të tepërta në BeH;
- Të monitorojnë punën e Bordit të Bashkërendimit për Kontrollin e SALW.

Kroacia

Progresi i bërë në lidhje me SALW

Kroacia i nisi bisedimet zyrtare për t'u pranuar në BE në muajin tetor 2005 dhe, që nga ajo kohë, Komisioni Evropian e ka përfshirë monitorimin e progresit të Kroacisë në fushën e kontrollit të SALW si pjesë të procesit të verifikimit. Kroacia ka aderuar më pas në shumicën e akteve përkatëse ndërkombëtare për kontrollin e SALW, duke shënuar si sukses të saj të fundit anëtarësimin në Marrëveshjen e Vasenar-it në vitin 2005.¹ Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit autoritetet kroate kanë zbatuar gjithashtu një sërë programesh për grumbullimin e armëve, që kanë sjellë si rezultat mbledhjen e afër 15.000 armëve; 450 kilogramëve të mjeteve shpërthyes dhe 552.000 predhave të municionit gjatë amnistive të realizuara në tërë vendin në shtator 2007 – mars 2008.² Hyrja e Kroacisë në NATO në prill 2009 nënkuptoi rritje të shpenzimeve ushtarake, dhe qasje më të përqendruar në freskimin dhe magazinimin e armatimeve të vjetra.

Progresi i vazhdueshëm i Kroacisë drejt anëtarësimit në BE siguron aderim në të gjitha standardet ndërkombëtare.

¹ Marrëveshja e Vasenar-it për Kontrollin e Eksportit të Armëve Konvencionale dhe Mallrat e Teknologjitë me Përdorim të Dyfishtë.

² <http://europeandcis.undp.org/poverty/mdghdpm/show/B93B9EE1-F203-1EE9-B9BBDE4602211C40>

Aktet ndërkombëtare

Statusi i pjesëmarrjes së Kroacisë dhe zbatimi i akteve përkatëse për kontrollin e SALW:

Akti ndërkombëtar	Data e aderimit ose e ratifikimit
Qëndrimi i Përbashkët i BE-së për Eksportet e Armëve	Gusht 2002
Qëndrimi i Përbashkët i BE-së për sa i përket Ndërmjetësimit për Armët	Plotësisht
Direktiva e BE-së për Kontrollin e Blerjes dhe Mbajtjen e Armëve	Dispozita të përfshira në legjislacionin kombëtar
Dokument i OSBE-së për SALW	Nëntor 2000
Dokument i OSBE-së për Stoqet e Municionit Konvencional	Dhjetor 2003
Vendimi i OSBE-së për MANPADS	Korrik 2003
Vendimi i OSBE-së për Ndalimin e Certifikatave të Përdoruesit	Nëntor 2004
Vendim i OSBE-së për Ndërmjetësimin	Nëntor 2004
Plani i Paktit të Stabilitetit qo do të zbatohet në nivel rajonal për Armët e Vogla dhe Armët e Lehta	Nëntor 2001
Programi i Veprimit të Kombeve të Bashkuara për SALW	Korrik 2001
Protokolli i Kombeve të Bashkuara për Armët e Zjarrit	Shkurt 2005
Marrëveshja e Vasenar-it	2005

Rekomandime për parlamentarët kroatë

- Të mbështeten në mekanizmat ekzistues të mbikëqyrjes me qëllim që veprimtaritë për eksportin e armëve të hetohen rregullisht nga komisioni i mbikëqyrjes;
- Të sigurojnë shkëmbimin e efektshëm të informacionit dhe bashkëpunimin mes Komisionit për Sigurinë Kombëtare dhe Këshillit për Mbikëqyrjen e Shërbimeve të Sigurisë;
- Të sigurojnë pjesëmarrjen dhe mbikëqyrjen e Komisionit Kombëtar për Armët dhe Municionet;
- Të ftojnë Qeverinë të botojë një raport vjetor për eksportin e armëve;
- Të mbrojnë shpërndarjen e fondeve të mjaftueshme buxhetore për zbatimin e kontrollit të armëve të vogla dhe armëve të lehta nga ana e Qeverisë.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë

Progresi i bërë në lidhje me SALW

Qeveria e IRJ të Maqedonisë e ka deklaruar kontrollin e armëve të vogla dhe armëve të lehta si përparësi të rëndësishme dhe, në qershor 2005, miratoi Strategjinë e saj të parë Kombëtare për Kontrollin e SALW. Qeveria gjithashtu e ka rregulluar formalisht shkatërrimin e armëve të vogla dhe të lehta, duke miratuar një udhëzim që parashikon asgjësimin çdo vit e të gjitha armëve të mbledhura dhe të sekuestruara. Në vitin 2008, për shembull, rreth 1.000 armë dhe 130,000 copë municion janë asgjësuar me vendim të gjyqit.¹

Progresi i madh është shënuar me miratimin e ligjit për përdorimin dhe mbajtjen e armëve, ligj ky që përputhet me standardet përkatëse të BE-së. Qeveria vazhdon të publikon raporte vjetore për transportet e armëve në pajtim me Qëndrimin e Përbashkët të BE-së.

Në vitin 2008 Ligji për Armë është ndryshuar për herë të tretë², dhe një sërë ligje të reja që kanë të bëjnë me kontrollin e SALW janë miratuar që nga viti 2007.³

¹ <http://www.un-casa.org/CASACountryProfile/PoANationalReports/2009@116@2009%2006%2029%20Macedonia%20report.pdf>

² Amendamenti 86/2008

³ <http://www.un-casa.org/CASACountryProfile/PoANationalReports/2009@116@2009%2006%2029%20Macedonia%20report.pdf>

Aktet ndërkombëtare

Statusi i pjesëmarrjes së IRJ të Maqedonisë dhe zbatimi i akteve përkatëse për kontrollin e SALW:

Akti ndërkombëtar	Data e aderimit ose e ratifikimit
qëndrimi i Përbashkët i BE-së për Eksportet e Armëve	Nëntor 2004
Qëndrimi i Përbashkët i BE-së për sa i përket Ndërmjetësimit për Armët	Qershor 2005
Direktiva e BE-së për Kontrollin e Blerjes dhe Mbajtjen e Armëve	Qershor 2005
Dokument i OSBE-së për Armët e Vogla dhe Armët e Lehta	Nëntor 2000
Dokument i OSBE-së për Stoqet e Municionit Konvencional	Dhjetor 2003
Vendimi i OSBE-së për MANPADS	Korrik 2003
Vendimi i OSBE-së për Ndalimin e Certifikatave të Përdoruesit	Nëntor 2004
Vendim i OSBE-së për Ndërmjetësimin	Nëntor 2004
Plani i Zbatimit Rajonal i Paktit të Stabilitetit për SALW	Nëntor 2001
Programi i Veprimit të Kombeve të Bashkuara për Armët e Vogla dhe Armët e Lehta	Korrik 2001
Protokolli i Kombeve të Bashkuara për Armët e Zjarrit	Shtator 2007

Rekomandime për parlamentarët maqedonas

- Të propozojnë masa për krijimin e mbikëqyrjes së efektshme të politikave qeveritare për kontrollin e SALW dhe zbatimin e tyre;
- Në dritën e reformave që po bëhen në Polici dhe Ushtri, të bëjnë lobim për përlogaritjen reale të kërkesave të drejta për stoqe kombëtare dhe më mirë të mbështesin shkatërrimin e menjëhershëm sesa shitjen e armëve dhe municioneve të tepërta; dhe
- Të propozojnë shpërndarjen e fondeve buxhetore për të mbështetur punën e Komisionit Kombëtar për SALW dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për SALW.

Mali i Zi

Progresi i bërë në lidhje me SALW

Republika e Malit të Zi, që sapo është shpallur e pavarur, ka mundësinë të vazhdojë të mbështetet në nismat e suksesshme për kontrollin e SALW që janë ndërmarrë tashmë. Mes tyre renditet miratimi i një Strategjie Kombëtare për Kontrollin e SALW dhe një Plani Kombëtar Veprimi për SALW, gusht 2005, si dhe krijimi i një Komisioni ndërministror për SALW. Mali i Zi ka përfunduar me sukses dy programe për grumbullimin e SALW.

Në vitin 2007 Mali i Zi publikoi Raportin e saj të Parë për Eksportet e Armëve për periudhën kohore prej pavarësisë së saj në qershor 2006 deri më 31 dhjetor 2006.

Në dhjetor 2008 Parlamenti i Malit të Zi ndryshoi Ligjin për Tregti të Jashtme të Armëve, Pajisjeve Ushtarake dhe mallrave me përdorim të dyfishtë përfshirë këtu mes tjerash edhe kriteret e Qëndrimit të Përbashkët të BE-së.¹ Ky ligj gjithashtu kap kontrollin e aktiviteteve ndërmjetësuese², sipas së cilit parashihet që një licencë për ndërmjetësim duhet të kërkohet nga autoritetet e vendit ku ndodh ndërmjetësimi, ose në vendin ku gjendet selia apo vendbanimi i ndërmjetësuesit.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit mes Malit të Zi dhe BE-së është fillimi i një procesi, i cili krijon mundësinë që Mali i Zi ta arrijë objektivin për t'u bërë shtet anëtar i BE-së. Gjatë një pjese të këtij procesi Malit të Zi do t'i duhet t'i japë përgjigje pyetësorit të Komisionit Evropian që lidhet me SALW (shih Shtojcën F).

¹ 2008/944/CFSP (Nenet 18, 19, dhe 20 të Ligjit)

² Neni 3, paragrafi 1 i Qëndrimit të Përbashkët të Këshillit të Bashkimit Evropian (2003/468/CFSP)

International instruments

Montenegro became a member of the United Nations and the Organisation for Security and Cooperation in Europe in 2006. Now the country needs to align itself with international and regional agreements on SALW Control and information-exchange.

Akti ndërkombëtar	Angazhime të reja
Qëndrimi i Përbashkët i BE-së për Eksportet e Armëve	Pjesërisht 2008
Qëndrimi i Përbashkët i BE-së për sa i përket Ndërmjetësimit për Armët	Pjesërisht 2008
Direktiva e BE-së për Kontrollin e Blerjes dhe Mbajtjen e Armëve	Pjesërisht 2009
Dokument i OSBE-së për Armët e Vogla dhe Armët e Lehta	Qershor 2006
Dokument i OSBE-së për Stoqet e Municionit Konvencional	Qershor 2006
Vendimi i OSBE-së për MANPADS	Qershor 2006
Vendimi i OSBE-së për Ndalimin e Certifikatave të Përdoruesit	Qershor 2006
Vendim i OSBE-së për Ndërmjetësimin	Qershor 2006
Plani i Zbatimit Rajonal i Paktit të Stabilitetit	Qershor 2006
Programi i Veprimit të Kombeve të Bashkuara për SALW	Qershor 2006
Protokolli i Kombeve të Bashkuara për Armët e Zjarrit	Dhjetor 2006

Rekomandime për parlamentarët malazezë

- Të mbështesin aderimin dhe ratifikimin e të gjitha akteve ndërkombëtare për kontrollin e SALW;
- Të propozojnë masa për krijimin e mbikëqyrjes së efektshme parlamentare të mekanizmave e transportit të armëve;
- Të mbështesin punën e Komisionit Kombëtar për SALW dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Kontrollin e SALW me alokimin e mjaftueshëm buxhetor.

Serbia

Progresi i bërë në lidhje me SALW

Serbia aderoi në Kodin e Etikës të Bashkimit Evropian në muajin mars 2005 dhe miratoi ligje të reja për transportin e armëve, të cilat përgjithësisht përputhen me standardet e BE-së. Fushatat për amnisti ishin posaçërisht të suksesshme në Serbi. Afër 30.000 armë u caktuan për asgjësim në janar të vitit 2007, ndërkohë që në muajin shkurt rreth 8.000 armatime u dorëzuan gjatë një fushate amnistie tjetër të organizuar.¹ Ministria e Brendshme mbikëqyri asgjësimin e afër 27,000 armëve të vogla në vitin 2009.²

Në dhjetor 2009 Serbia dorëzoi kërkesën oficiale për anëtarësim në BE, pasi që më parë në vitin 2007 kishte nënshkruar marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Pjesë e kushtit për anëtarësim është pranimi i kushteve të parashtruara në lidhje me kontrollin e armëve. Në dhjetor 2007, Serbia publikoi Raportin për Realizimin e Transportit Tregtar të Jashtëm të Mallrave të Kontrolluara për periudhën kohore 2005 deri 2006, dhe në nëntor 2008 Qeveria miratoi Vendimin për pranimin e kritereve të dalë nga Qëndrimi i Përbashkët i BE-së për Eksportet e Armëve.

¹ <http://www.un-casa.org/CASACountryProfile/PoANationalReports/2008@169@Serbia.pdf>

² <http://www.seesac.org/activities/activities-2009/destruction-serbia/1/>

International instruments

Akti ndërkombëtar	Data e aderimit ose e ratifikimit
Qëndrimi i Përbashkët i BE-së për Eksportet e Armëve	2005
Qëndrimi i Përbashkët i BE-së për sa i përket Ndërmjetësimit për Armët	Pjesërisht
Direktiva e BE-së për Kontrollin e Blerjes dhe Mbajtjen e Armëve	Jo
Dokument i OSBE-së për SALW	Nëntor 2000
Dokument i OSBE-së për Stoqet e Municionit Konvencional	Dhjetor 2003
Vendimi i OSBE-së për MANPADS	Korrik 2003
Vendimi i OSBE-së për Ndalimin e Certifikatave të Përdoruesit	Nëntor 2004
Vendim i OSBE-së për Ndërmjetësimin	Nëntor 2004
Plani i Zbatimit Rajonal i Paktit të Stabilitetit	Nëntor 2001
Programi i Veprimit të Kombeve të Bashkuara për SALW	Korrik 2001
Protokolli i Kombeve të Bashkuara për Armët e Zjarrit	Dhjetor 2007

Rekomandime për parlamentarët serbë

- Të mbikëqyrin dhe të sigurojnë kapacitetet e Qeverisë për të zbatuar ligjin për kontrollin e SALW;
- Të kërkojnë miratimin nga ana e Qeverisë e një Strategjie Kombëtare për Kontrollin e SALW;
- Të mbështesin krijimin e një Komisioni Kombëtar për SALW;
- Të nxisin transparencë në lidhje me SALW përmes mbikëqyrjes së rregullt parlamentare të mekanizmave të kontrollit SALW;
- Të shqyrtojnë legjislacionin ekzistues për mbajtjen e SALW, transportin ndërkombëtar dhe standardet kombëtare të sigurisë për ruajtjen e rezervave me synim harmonizimin me politikën dhe praktikën më të mirë të BE-së.

Shtojca D – Çfarë mund të bëni ju si parlamentar ¹

Rolet e parlamentarëve

Fusha

Përfaqësues

Të gjitha fushat që lidhen me SALW

- Mund të ngrini te ekzekutivi çështje që përbëjnë shqetësim (dhuna e armatosur, çdo shpërdorim i armëve të zjarrit nga ana e forcave shtetërore të sigurisë etj.)
- Të merrni pjesë si anëtarë të delegacioneve zyrtare në konferenca, seminare etj. për SALW.

Çështje legjislative dhe rregullator

- Të veproni si përfaqësues parlamentarë në Komisionin Kombëtar për Armët e Vogla dhe Armët e Lehta.

Përhapja e SALW

- Të përcaktoni nëse zona juaj zgjedhore është prekur nga përhapja e armëve të vogla dhe armëve të lehta dhe t'u propozoni autoriteteve vendore kundërmasa të përshtatshme.
- Të informoni popullatën për përpjekjet e Parlamentit në drejtim të zvogëlimit të përhapjes së SALW.

¹ Disa çështje janë nxjerrë nga "Mbikëqyrja parlamentare në fushën e sigurisë", DCAF, Gjenevë, 2004.

Ligjvënës

- Të inicioni rregullisht ligje ose të ndryshoni legjislacionin ekzistues me qëllim që t'i përfshini angazhimet dhe politikat kombëtare dhe ndërkombëtare për kontrollin e SALW në sistemin ligjor kombëtar.
- Të inicioni ligje të reja ose të propozoni një analizë të plotë të legjislacionit ekzistues për mbajtjen e armëve nga civilët, transportin e armëve dhe kontrollet e eksportimit, proceset e grumbullimit vullnetar të armëve etj.
- Të kërkonti që kontrolli i tregtisë ndërkombëtare të armëve të jetë në krye të programit parlamentar.
- Të shqyrtoni përfshirjen e legjislacionit për një moratorium të përkohshëm për shitjen e tepçicave të SALW derisa Qeveria të miratojë një Strategji Kombëtare për SALW.
- Të kërkonti nga Qeveria të vendosë masa të duhura dhe efektive për të frenuar korrupsionin që shoqëron prodhimin, trafikimin, dhe mbajtjen dhe përdorimin kundraligjor të SALW.

Mbikëqyrës

- Të vazhdoni rregullisht mbikëqyrjen parlamentare të politikave të Qeverisë për SALW.
- Të siguroni që ekzekutivi i respekton dhe i zbaton angazhimet e veta ndërkombëtare (p.sh. traktatet, konventat etj.).
- Të inkurajoni shtetin tuaj të realizojë rregullisht përputhjen me kërkesat e raportimit që përmbajnë mekanizmat dhe aktet për kontrollin e SALW (p.sh. Dokumenti i OSBE-së për SALW, UN PoA etj.).
- Të siguroni që të ekzistojë një mekanizëm, i cili e detyron Qeverinë të paraqesë në Parlament raporte vjetore për çështje të eksportit dhe transportit të armëve.
- Të bëni kujdes që të ekzistojë një mekanizëm, i cili e detyron Qeverinë të paraqesë në Parlament raporte vjetore për zbatimin e një Strategjie Kombëtare për Kontrollin e SALW.
- Të kërkonti nga Qeveria juaj të respektojë embargot për armët dhe të siguroni zhdëmtim dhe sanksione në raste të shkeljes së embargove për armët.
- Të siguroni një politikë kombëtare të përditësuar për transportin e armëve dhe të siguroheni se ajo është paraqitur si duhet për miratim në Parlament.
- Të kërkonti nga Parlamenti ose komisioni(komisionet) e tij kompetente që t'i kushtojnë vëmendje të posaçme çështjes së armëve dhe municioneve të tepërta dhe të merrni masa me qëllim që të parandalohet ose kontrollohet çdo transportim i armëve të tepërta nga ose nëpërmjet vendit tuaj.
- Të nxisni më tej Qeverinë që të ndër marrë hapa për të identifikuar ato kompani që janë të përfshira në importin, transportin apo eksportin e kundraligjshëm të armëve dhe municioneve dhe të kontrolloni veprimtaritë e tyre.

Rolet e parlamentarëve

Fusha

Përfaqësues

Vëzhgimi i SALW

- T'u shpërndani autoriteteve vendore në zonën tuaj zgjedhore konkluzionet e vëzhgimit për SALW dhe të monitoroni ecurinë e zbatimit të çdo rekomandimi të këtij vëzhgimi.

Sensibilizimi për armët e vogla dhe armët e lehta SALW

- Të rrisni sensibilizimin për këtë çështje në media, në zonën tuaj zgjedhore dhe në shoqërinë civile, duke përcaktuar problemet që lidhen me armët e vogla në nivel të bashkësisë dhe duke nënvizuar shkaqet.
- Të ndikoni te Qeveria që të ndër marrë hapa duke e bërë kontrollin e armëve të vogla dhe armëve të lehta një çështje politike.

Grumbullimi i SALW

- Të diskutoni me autoritetet vendore në zonën tuaj zgjedhore për nevojën e kryerjes së grumbullimeve vendore të SALW dhe për mbështetjen e përpjekjeve të tyre.

Shkatërrimi i SALW

- Të mbështesni në deklarata publike në forume kombëtare dhe ndërkombëtare asgjësimin e tepricave të SALW.

Kontrollet në pikat e kalimit kufitar

- Të mbështesni dhe të bëni publike masat për forcimin e sigurisë kufitare në lidhje me SALW. Të theksoni pasojat e tregtisë kundraligjore me armë.

Ligjvënës

- Të jepni përparësi për resurset adekuate për të vazhduar vëzhgimin e rregullt kombëtar të SALW.
- Të propozoni alokime të rregullta nga buxheti për fushata sensibilizimi në lidhje me SALW.

Mbikëqyrës

- Të kërkonti që Qeveria të kryejë grumbullimin dhe analizën e duhur e të dhënave për SALW dhe t'i përshtatë politikat e veta për SALW në bazë të rezultateve të tyre.
- Të kërkonti përditësim nga Qeveria për efektshmërinë e fushatave sensibilizuese për SALW.

- Të sensibilizoni çështjet relevante për grumbullimin e SALW në qarqet e nevojshme legjislative, dhe të siguronit se resurse të duhura janë ndarë për fushata për grumbullimin e tyre në të ardhmen.

- Të propozoni alokime nga buxheti për asgjësimin e tepricave të SALW.

- Të shqyrtoni propozimin për vënien në dispozicion të burimeve financiare për zbatimin e një sistemi të integruar të administrimit të kufijve.

- Të kërkonti që Qeveria të miratojë ose ndryshojë aktet nënligjore për grumbullimin e SALW që ato të pasqyrojnë “praktikat më të mira” ekzistuese ndërkombëtare’.
- Të monitoroni dhe të kërkonti nga Qeveria raporte zyrtare për sukseset ose dështimet e grumbullimit të SALW.

- Të nxisni Parlamentin ose komisionin(komisionet) e tij kompetente që t'i kushtojnë vëmendje të posaçme çështjes së armëve dhe municioneve të tepërta dhe të ndërmarrin hapa për asgjësimin e shpejtë të çdo teprice.

- Të kërkonti miratimin e një programi të integruar për administrimin e kufijve nga ana e Qeverisë dhe të monitoroni zbatimin e tij.
- Të nxisni rritjen e bashkëpunimit me shtetet fqinjë për kontrollet kufitare.

Shtojca E – Botime të dobishme për armët e vogla dhe të lehta

Vendi	Botimi
Rajoni	Zbatimi i Qëndrimit të Përbashkët të BE për Kontrollin e Ndërmjetësimit për Armë, SEESAC, 2009
	Raporti Rajonal për eksportin e armëve, SEESAC, 2009
	Armët Konvertibile në Ballkanin Perëndimor, SEESAC, 2009
	Shndërrimi i Mbrojtjes Hedhja dhe Demilitarizimi i Sistemeve të Rënda të Armatimit, SEESAC, 2007
	Pushkët, Avionët dhe Anijet Identifikimi dhe Ndërprerja e Transportit të Fshtë të Armëve, SEESAC, 2007
	Pakoja 3 për Mbështetje të Sensibilizimit për SALW, SEESAC, 2007
	Mbajtja e Armëve të Zjarrit dhe Dhuna në Familje në Ballkanin Perëndimor Studim Krahasues të Legjislacionit dhe Mekanizmat e Zbatimit, SEESAC, 2007
	Analizë e Legjislacionit Nacional për Eksportin dhe Transportin e Armëve në Ballkanin Perëndimor, SEESAC, 2006
	Monitorimi i SALW në Evropën Juglindore 2006
	Monitorimi i SALW në Evropën Juglindore 2005
	Monitorimi i SALW në Evropën Juglindore 2004
	Standarde dhe udhëzues për mikro-çarmatimin rajonal në Evropën Juglindore (RMDS/G), SEESAC, 2006
	“Kultura e armëve në Evropën Juglindore”, SEESAC / CSD, 2006
	“SALW dhe kompanitë private të sigurisë në Evropën Juglindore”, SEESAC / IA / Saferworld, 2005
Shqipëria	“Të kthesh faqen”, Vëzhgim për SALW në Shqipëri, Saferworld / CPDE, 2005
	“Keni nxjerrë djallin nga dera jonë”, Vlerësim i projektit të PNUD-it për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe Armëve të Lehta në Shqipëri, SEESAC / BICC, 2003

Vendi	Botimi
Bosnjë-Hercegovina	<p>“Studim për zbatueshmërinë e demilitarizimit të municionit në Bosnjë-Hercegovinë”, SEESAC / TRL, 2006</p> <p>Vëzhgim për SALW në Bosnjë, SEESAC / BICC, 2004</p>
Kroacia	<p>Vëzhgimi për Perceptimin e Sigurisë në Kroaci, PNUD Kroaci, Gfk Kroaci, 2009</p> <p>Vëzhgim për SALW në Kroaci, SEESAC / BICC, 2006</p>
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	<p>“Një paqe e brishtë: armët e zjarrit dhe siguria në Maqedoni pas konfliktit”, Vëzhgim për SALW në Maqedoni, SEESAC / Vëzhgim për Armët e Vogla, 2004</p>
Mali i Zi	<p>Legjislacioni për SALW në Malin e Zi Pajtueshmëria me Rregullativat e BE-së, SEESAC, 2009</p> <p>Vlerësim Teknik i Municionit në Malin e Zi, SEESAC, 2007</p> <p>Armët e Vogla dhe Dhuna me bazë Gjinore në Malin e Zi, SEESAC, 2007</p> <p>‘Shtëpia s’është shtëpi pa një pushkë’, Vëzhgim për SALW në Malin e Zi, SEESAC / Vëzhgim për Armët e Vogla, 2004</p>
Serbia	<p>“Të jetosh me trashëgiminë”, Vëzhgim për SALW në Serbi, SACISCG i PNUD-it, 2005</p> <p>“Perceptimet publike të armëve të vogla dhe sigurisë në Serbinë Jugore”, SEESAC / SMMRI, 2003</p>


Shtojca F – Pyetje të Komisionit Evropian për armët e vogla dhe armët e lehta ¹

P. A mund të jepni sqarime për tregtinë e mallrave me përdorim të dyfishtë dhe armëve konvencionale që bën vendi juaj qoftë drejtpërsëdrejti qoftë si pikë transiti? Cilat do të ishin mekanizmat kombëtare për të zbatuar kontrollet e brendshme të nevojshme, të cilat bëjnë të mundur që akte të tilla, si Marrëveshja e Vasenar-it, Grupi i Australisë dhe regjimet e MTCR, të sjellin rezultate dhe cilat do të ishin agjencitë përkatëse të zbatimit të ligjit për secilin prej këtyre regjimeve të mospërhapjes?

P. Në lidhje me armët e vogla dhe armët e lehta, lutemi jepni hollësi për çështjet e mëposhtme:

- f. A e keni legjislacionin për kontrollin e brendshëm të armëve të vogla dhe armëve të lehta, përfshirë mbajtjen, përdorimin, transportin dhe regjistrimin e armëve? A e keni legjislacionin për transportin me jashtë (importin, eksportin, transitin etj.) të këtyre armëve në përputhje me Qëndrimin e Përbashkët të BE-së për Eksportin e Armëve të 2008? A keni plane për ta ndryshuar legjislacionin ekzistues?
- g. A keni ndonjë strategji kombëtare për kontrollin e armëve të vogla dhe armëve të lehta? Në qoftë se po, lutemi paraqisni një kopje.
- h. A keni ndonjë komision ose autoritet kombëtar që monitoron prodhimin, importin dhe eksportin e armëve të vogla dhe armëve të lehta? Në qoftë se po, cilët janë anëtarët dhe cilat janë termat e tij të referencës?
- i. A keni ndonjë sistem kombëtar regjistrimi dhe ndonjë bazë e të dhënave për armët e vogla dhe armët e lehta? Në qoftë se po, lutemi paraqisni statistikën e fundit për regjistrimin e armëve.
- j. A keni standarde kombëtare për lëvizjen e municioneve dhe lëndëve plasëse në përputhje me Marrëveshjen Evropiane në lidhje me Transportin Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme (ADR)?

¹ Ekstrakt nga Kapitulli 27 'Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë'.



Horizontal lines for writing, consisting of 18 evenly spaced blue lines across the page.



CIP – Каталогизација у публикацији
Народна библиотека Србије, Београд

341.678 (4-12) (035)
623.44 (4-12) (035)
351.753 (4-12) (035)

Armët e Vogla dhe Armët e Lehta në Evropën Juglindore:
Manual për Parlamentarët 2010. - Belgrade : SEESAC, 2010
(Belgrade : Publikum). - 40 str. ; 21cm

Izv. stv. nasl. : SALW in South Eastern Europe.
- Tiraž 100. - Napomene i bibliografske reference uz tekst.

ISBN 978-86-7728-130-4

a) Контрола наоружања - Југоисточна Европа
- Приручници b) Лако наоружање -
Југоисточна Европа - Приручници
COBISS.SR-ID 174941196